



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KRYETARJA E KOMUNËS

Nr 01-132-11829 /2016

Dt: 03.03.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të në nenit 40 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, neni 12 paragrafi 1, 2 dhe 11 pika 2.1,2.2, neni 14 të Rregullores nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, me dt.03.03.2016, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësja civile znj.Tringa Haxhidauti, e sistemuar në punët dhe detyrat e punëve Bibliotekiste, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i lejohet shfrytëzimi i Pushimit prindëror (i lehonisë) duke filluar nga dt. 01.03.2016 deri më dt. 30.11.2016.
2. Nëpunëses pushimi prindëror (i lehonisë) i lejohet dyzetepesë (45) ditë, para datës së lindjes për arsye të komplikimeve të vazhdueshme të shtatzansis sipas rekomandimit të mjekut.
3. Nëpunësja në fjalë pas shfrytëzimit të pushimit prindëror (lehonisë), rikthehet në pozitën e mëparshme.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile znj.Tringa Haxhidauti më dt. 10.02.2016 ka parashtruar kërkesën Nr.10-132/7591 për pushim prindëror (të lehonisë) duke filluar nga dt. 01.03.2016 deri më dt. 30.11.2016, e cila ka nevojë për regjim shtrati për ta mbrojtur shtatzansinë meqenëse është në gjendje jo të mirë shëndetësore me komplikime të vazhdueshme, tretman mjekësor dhe sipas mjekut për shkak të gjitha këtyre vështirësive të cilat e shoqerojnë këtë shtatzansi dhe mundësisë se lindjes së parakohshme, pacientes i sygjerohet regjim shtrati.

Bashkangjitur raportin mjekësor i lëshuar nga Shërbimi Spitalor dhe Kliniko Universitar i Kosovës-Spitali i Përgjithshëm “ Isa Grezda “ në Gjakovë, nga mjeku konsulent dr. Butrint Kusari – Gjinekolog – Obstetrik.

Duke vlerësuar arsyeshmërinë e kërkesës dhe pëlqimin e Kryetares së Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në përputhshmëri të dispozitave të nenit 40 par.1 pika 1.4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 12 par.1,2 dhe 11 pika 2.1,2.2, neni 14 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, nëpunëses civile znj.Tringa Haxhidauti, i lejohet shfrytëzimi i pushimit prindëror (të lehonisë) prej nëntë (9) muajsh me kompensim si në vijim: gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunëses, tre (3) muajt në vijim, paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, vendosi si në dispozitiv.

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Nëpunësja civile e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Aktvendimi te Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Vendim t`iu dorëzohet:

- Nëpunëses civile Tringa Haxhidauti.

Me kopje të Vendimit të pajisen:

- Zyra e Kryetares,
- Drejtori i DKRS,
- Zyra e personelit,
- Drejtori i DBF,
- Zyrtari i pagave dhe
- Arhiva e Komunës.

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari – Eila,

